

**RAPORT
PARAPRAK I
VLERSIMIT TE
NDIKIMIT NE
MJEDIS**



**PROJEKTI:
GODINË BANIMI DHE SHERBIMI 3-
4-6 KATE ME 1 KAT NËNTOKE LAGJA
18, RR. "PASKAL PRODANI", DURRES.**

**REFERUAR LIGJIT NR:10440, I NDRYSHUAR,
SHTOJCA 2. KODI 3**

Permbajtja

.....	4
1. Përshkrimi i mbulesës bimore;.....	4
2. Informacion për praninë e burimeve ujore,.....	7
3. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;	12
3.1 Ndikimet negative ne mjedis	12
3.2 Ndikimet ne biodiversitet.....	13
3.3 Ndikimet në ujë.....	14
3.4 Ndikimet në tokë.....	15
Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes.....	17
3.5 Ndikimet në ajër.....	17
3.6 Ndikimi ne peisazh dhe vizualiteti.....	18
3.7 Përmbytjet.....	18
3.8 Ndikimi ne trashëgimisë natyrore dhe zonat e mbrojtura.....	19
3.9 Çështjet social ekonomike	19
3.10 Ndikimi në infrastrukturë.....	19
3.11 Trashëgimia kulturore.....	20
3.12 Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.....	20
3.13 Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.....	21
4. Shkarkimet e mundshme në mjedis.....	22
4.1 Shkarkimet eujëravetëndotura	22
4.2 Shkarkimet e gazeve dhe pluhurave.....	23
4.3 Zhurmat	24
4.4 Vibrimet.....	24
4.5 Prodhimet e mbetjeve	25
5 Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative t ëidentifikuara.....	26
6 Tëdhëna përshtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis.....	29
6.1 Distancën fizike nga vendndodhja e projektit.....	29
6.2 Vlerat endikuara.....	29

7 Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar	31
7.1 Mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme.....	31
7.2 Kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.....	33
8. Masat e mundshme përshimgjen dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;	35
Biodiversitet	35
Ujrat nëntoksore	35
Ujërat sipërfaqësore	35
Cilesia e tokës	36
Tektonia dhe sizmiciteti	36
Gjeologjia.....	36
Per cilesine e ajrit.....	37
Zhurmat.....	38
Vibrimet	39
Peisazhi dhe çështjet vizuale.....	40
Përmbytjet	40
Çështjet socio-ekonomike,	41
Trashëgimia kulturore	41
Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.....	41
Parandalimi i rreziqeve	42
Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria	43
Gjenerimi i mbetjeve.....	44
9. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar	44
10. Përfundime	45

HYRJE

Qyteti i Durrësit, si qyteti i dytë më i madh në Shqipëri, po zhvillohet në mënyrë intesive nga ana urbane, dukë u prezantuar gjithnjë e më modern dhe mjaft tërheqës, favorizuar dhe nga pozita gjeografike bregdetare e tij.

Në kuadrë të këtij progresi dhe në përputhje me planet e zhvillimit urban të këtij qyteti, është hartuar projekti, Godine Banimi dhe Sherbimi 3-4-6 kate, me 1 kat nentoke do të ndërtohet në Lagjen 18, Rr. "Paskal Prodani", të qytetit të Durrësit. Ky projekt është hartuar nga "S&L STUDIO", "ARKON STUDIO", "GB-A STUDIO" dhe do të zhvillohet nga subjekti "KRISTI KONSTRUKSION 2003".

Bazuar në Ligjin me nr.10440 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 7 "Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" I ndryshuar, pika 3, ky projekt përfshihet në shtojcën II, "Projektet që I nështrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis". Sipas natyrës së tij, projekti përfshihet tek pika 10 e kesaj shtojce, "Prodhime infrastrukturore", çështja b "Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qëndrave tregtare dhe parkimet për makinat".

Strukturimi i këtij raporti është bërë në përputhje me kriteret për këtë qëllim të përcaktuara në Kreun I, pika 1.2 si dhe të shtojcës I, të VKM nr.686, datë 29.7.2015, për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

Vlerësimi I ndikimit në mjedis (VNM është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

Pergatitja e këtij raporti është në përputhje me kërkesat e VKM me nr.686, date 29.7.2015 "Përmiratimi në rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"

Pika e 1 e Kreut të parë e këtij vendimi shprehet se "1. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekti i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, qënë fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin" përkatës ku përshihet dhe Raportin paraprak i VNM-së. Struktura e këtij raporti është në përputhje me të gjitha çështjet e përcaktuara në pikën 1.2 të këtij vendimi

Raport i përmbledhur (paraprak) i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka si qëllim:

Identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në mjedis si rezultat i zbatimit të projektit të propozuar;

Evidentimin e sigurimin e masave që zbusin ose kompensojnë ndikimet negative në mjedis si rezultat i zbatimit të këtij projekti.

Monitorimin e procesit të zbatimit të projektit për të garantuar respektimin e e ketyre masave.

Zbatimi i këtij projekti ka të bejë më ndërtimin e një Godine Banimi dhe Sherbimi 3-4-6 kate, me 1 kat nentoke në Lagjen 18, Rr. “Paskal Prodani”, të qytetit të Durrësit.



Figure 1 Vendodhja e objektit te propozuar

1. Përshkrimi i mbulesës bimore;

Zona ku ndodhet qyteti i Durrësit karakterizohet ngabiodiversitetit pikmesdhetare. Llojshmeria e habitateve ku spikat diversiteti floristik shtrihet kryesisht ne një riliev kodrinor përreth qytetit si dhe zonat e rrafshta të tij ose ku zhvillohet aktivitet kryesisht bujqesor.

Vegjetacioni i zonës është i kondicionuara nga një serë faktorësh klimatik, edafik, e të rilievit. Per te vleresuar me mire mbulesen bimore vendosemi ne kontekstin fiziko gjeografike te rajonit.

Përgjithësisht bimësia natyrore e zonës së Durrësit karakterizohet nga një larmi llojesh si rezultati një ndryshueshmëri e të kushteve ekologjike e edafike të krijuara nga kombinimi i llojeve të tokës, reshjeve dhe pozicionit topografik. Në gjëndjen e sotme të habitateve veçanërisht në shperndarjen e bimësisë shprehet dhe ndikimi i madh i aktivitetit gjatë gjithë periudhave.

Në zonën e dunave të plazheve (dunat janë të dëmtuara) dallohen vatra me një fizionomi të vegjetacionit të marrë nga shoqërimet me llojet Cakile maritima, Xanthium strumarium,

Ammophila, Cyperus capitatus, Sporobolus pungens, Echinophora spinosa, Eryngium maritimum, Medicago marina etj. Ndersa gjandën dhe bimët me status të rrezikuar si Stachys maritima, Pancratium maritimum, Ammophila arenaria,.

Sidomos në zonat e sheshta, larmia flores barishtore përfaqësohet me një grade me të madhe mbulimi me llojetë familjeve Graminacea e Leguminacea si Festucasp, Trifolium, Viciaspp, Urtica dioica, Sanguisorba officinalis, Salvia sp, Melisa officinalis, Lulëkuqja (Papaver rhoeas), Bari i bletës (Melisa officinalis) Çikorja (Cichorium intybus), etj si dhe disa prej tyre kanë rëndësi mjeksore..

Flora drusore e shkurre natyrore dominohet nga prezenca e pishës bregdetare (Pinus sp.) Dëllinjën (Juniperussp), Frasherin (Fraxinus angustifolia) Shelgun Shqopën (Ericasp), (salixsp), Plepat (Populus spp), Selvinë (Cupressus sempervirens), Gjineshtrën (Spartium junceum), Trëndafilin egër (Rosacacina), Manaferra (Rubus fruticosus) etj.

Në mjaft rrugë të qytetit sidomos ajo e hyrjes deri tek Stacioni I Trenit janë mbjellë drurë dekorative të cilat e pasurojnë mjedisin urban të qytetit me elementë floristike me një ndikim pozitiv të pazëvendësueshëm jo vetëm në aspektin pejsazhist por dhe në cilësinë e mjedisit urban në tërësi.

Në mjediset e patrajuara plotësisht me infrastrukturë urbane, në hapësirat që pritet të zhvillohet, në anë të rrugëve të pasaflluara e vendeve të ngritura, gjanden bimë të tilla si Podiqja e eger (Agrimonia eupatoria), thundermushka (Tussilago farfara L.), kamomili i qenit (Anthemis cotula), cikorja (Cichorium intybus L.), lule dhensh (Bels perenis L.) kin fushe (Erithrea centarium), terfili i arave (Trifolium arvense) si dhe mjaft bime graminore. Në mjediset me të ulta ku ndjehet prezenca e ujërave nëntoksore, në kanale kulluese, takohen bimë të tilla si bargjaku (Lythrum salicaria L.) bimë të familjeve graminore si kuqela e ravenes (Erianthus ravena P.B.), mendra (Menta piperita L.) mendra gjethegjate (Mentha longifolia L.), menta e eger (Menta pulegium L.) menta e ujit, (Mentha aquatica).

Mjaft bimë barishtore që karakteristike të kësaj zone kanë vlera mjeksore si Festucasp, Melisa officinalis Trifolium, Sanguisorba officinalis, Viciaspp, Salvia sp, Urtica dioica, Lulëkuqja (Papaver rhoeas), Çikorja (Cichorium intybus), Bari i bletës (Melisa officinalis) etj.



Figure 2 Zona me pishë (Pinus sp.).

Hapësira te gjelbërta dhe të mbrojtura

Qyteti i Durrësit ka sipërfaqe dhe hapësira të gjelbërta, ku përfshihen parqet e ndryshme rrugët me gjelbërim të qytetit si dhe zonat përreth qytetit. Në tabelat en vijim¹ (sipërfaqe te gjelbërta të qytetit të Durrësit nëpër rrugët e qytetit dhe parqet e tij.

Nr.	Emërtimi(sipërfaqja e gjelbër në rrugë)	Gjatësia m	Sip.m ²
1	Rr. Dalip Peza + Isa Boletini	560	2688
2	Rr. J.Ballhysa + Hajdar Bardhi + Hysen Myshketa	730	3504
3	Rr. MujoUlqinaku	1280	6144
4	Rr. Maliq Muco(H. Kaculini)	380	1824
5	Rr. Shoqëria Bashkimi	380	1824
6	Rr. Bulevardi KryesorShetitorjaDyrrah	620	2976
7	Rr. Epidam(Rr. Tregtare)	570	2736
8	Rr. Haziz Podgorica (Fermentimi-St.Plazhit)	380	1824
9	Rr.Shëtitorja Egnatia (Rr.Skenderbej)	1080	5184
10	Rr. Adria + Bulevardi Dëshmorëve	1820	8736
11	Rr. Epikadeve (Rr. De Rada)	200	960
12	Rr.A.Celkupa+ KocoKazanxhi	670	3216
13	Rr. NekiLibohova + Pjetër Hanxhari	670	3216
14	Rr. Hysen Kërtusha	1080	5184
15	Rr. F.Durrsaku + G.Durrsaku	210	1008
16	Rr. Taulantia	480	2304
17	Rr. Aleksander Goga	1280	6144
18	Totali i NSHK Durrës	12390	59472
19	Rr. BajramTusha (Shkozeti)	1100	5280

Nr.	Emërtimi(sipërfaqe te parqeve të qytetit)	Sip.m ²
1	Parku i Vilës	40000
2	Qendra(Pallati A.Moisiu +Prefektura+Cedrus + Sokati)	6460
3	Muzeumi	8830
4	Centrali	468
5	Stacionii trenit+ para pallatit	3572
6	Gjethja	1684

Figure 3Bimesia shkurrore ne brigjet e bredgetit

VendortëqytetitëDurrësit, 2012

7	Shiriti i Rr. MujoUlqinaku	896
8	Lulishtja A.Durrsaku +Monumenti I Mujo Ulqinakut	3900
9	GrupikryqëzimiiPortit (Porti+Torra + Pionieri)	4718
10	Pionieri +Befotrofi	5179
11	20Shkurti	2925
12	Pallati i Sportit	4847
13	ShëtitorjaTaulantia	50096
14	Parku në hyrjetë Durrësit	13689
TOTALI		147264

Nga shifrat e mesiperme rezulton se sipërfaqja në m² për banorë është më e ulët sesa ajo e mesatares evropiane për banorë, (norma e tanishme kombëtare është 7m² për person, e cila përputhet pothuajse plotësisht me praktiken e vendeve të BE-së).

2)Informacion për praninë e burimeve ujore,

2.1.3urimet ujore

Mjedisi Detar

Mjedisi detar është një nga trupat ujore më të rëndësishme të Bashkisë Durrës dhe përbëhet nga disa element, të cilët duhen marrë në considerate për ta ruajtur atë.Qeveria Shqiptare perms rregullores Nr.177 të 31.03.2005, përcakton qartë rregullat për ruajtjen e këtij mjedisi të rëndësishëm.

Në vijën bregdetare me gjatësi të konsiderueshme të bashkisë Durrës ndodhen disa sipërfaqe që përdoren për plazh në muajt e verës dhe keshtu merr rëndësi të veçantë pastertia e tyre si dhe e ujrave detare që i lagin.Situata nëdisa prej plazheve ka qënë e përkeqësuar nga ndotjet ndersa vitet e fundit (2014) rezulton e permirsuar.

Ndotjaka ardhur nga numri I madh I ndërtimeve, mungesa e një sistemi kanalizimesh për ujërat e zeza dhe urbane, mungesa e impiantit përpunues të tyre, numri I madh I pushuesve dhe mungesa e shërbimeve higjeno-sanitarenë plazhet përkatëse, prania e portit më të madh të vendit si dhe nga mungesa e edukatës qytetare.

Monitorimi I ujit të detit në zona të ndryshme në Durrës ²							
NR	ADRESA	NO ₂	NH ₄	pH	Coliforme	E.coli	St.Faecal
1	Pistae Kokeve	ndot	ndot	8.24	+93	+93	--

² ISHP 2012

2	Kështjella	ndot	ndot	8.29	+43	+43	--
3	Aragosta	ndot	ndot	8.33	+93	+93	--
4	Tymi	ndot	ndot	8.32	+240	+240	--
5	Savana	ndot	ndot	8.28	+93	+93	--
6	Peroci	ndot	ndot	8.26	+93	+93	--
7	Gjermoni	ndot	ndot	8.30	+93	+9.3	--
8	Ura Dajlanit	ndot	ndot	8.24	+23	+23	--
9	Vapori	ndot	ndot	8.20	+43	+43	--
10	Rina	ndot	ndot	8.27	+23	+23	--
11	Breshka	ndot	ndot	8.23	+23	+23	--
12	Adriatiku	ndot	ndot	8.17	+75	+75	--
13	Pista Iliria e vogël	ndot	ndot	8.27	+43	+43	--
14	Pista Iliria e madhe	ndot	ndot	8.29	+23	+23	--
15	Kovalishenca eRendit	ndot	ndot	8.26	+460	+460	--
16	Forca Komando	ndot	ndot	8.30	+43	+43	--
17	Tropikali	ndot	ndot	8.31	+460	+460	--
18	Bregu Kanalit	ndot	ndot	8.35	+2400	+2400	--
19	Benilva	ndot	ndot	8.27			--
20	Xixa	ndot	ndot	8.29	+1100	+1100	--
21	Gjermoni	ndot	ndot	8.24	+99	+99	--
22	Ura Dajlanit	ndot	ndot	8.26			--
23	Kështjella	ndot	ndot	8.30	+23	+23	--
24	Aragosta	ndot	ndot	8.18	+4	+4	--
25	Ura eKokeve	ndot	ndot	8.23	+4	+4	--
26	PranëShëtitorës	ndot	ndot	8.40	+23	+23	--
27	PranëPortit Detar	ndot	ndot	8.24	+460	+460	--
28	Ura Dajlani	ndot	ndot	8.24	+4	+4	--
29	Vapori	s"ka	s"ka	8.18	+4	+4	--
30	Hekurudha	ndot	ndot	8.28	+7	+7	--
31	Pista Iliria e vogël	s"ka	s"ka	8.17	+7	+7	--
32	Pista Iliria e madhe	ndot	ndot	8.25	+4	+4	--
33	Blloku	ndot	ndot	8.26	+4	+4	
34	Ministria e Rendit	ndot	ndot	8.20	+4	+4	
35	Tropikali	s"ka	s"ka	8.19	+4	+4	
36	Forca Komando1	s"ka	s"ka	8.17	+4	+4	
37	Forca Komando2	s"ka	s"ka	8.18	+4	+4	
38	Kanali	ndot	ndot	8.28	+1100	+1100	
39	Namiku	ndot	ndot	8.30	+1100	+1100	
40	Benilva	ndot	ndot	8.27	+460	+460	
41	Xixa	ndot	ndot	8.29	+2400	+2400	
56	Tek Kompleksi Hasaneve	s"ka	s"ka	8.23	+20	+20	
57	Tek Pishat	s"ka	s"ka	8.20	0	0	
58	500 mposhtë Pishave	s"ka	s"ka	8.28	+9	+9	
59	Reparti Ushtarak	s"ka	s"ka	8.24	+4	+4	
60	Cikloam	s"ka	s"ka	8.20	+3	+3	
61	ParaPortit	s"ka	s"ka	8.18	+7	+7	
62	Portoromani(lokalioni)	s"ka	s"ka	8.21	+7	+7	
63	Sektori Rinia	s"ka	s"ka	8.25	+3	+3	
64	1000mngapika1	s"ka	s"ka	8.19	+3	+3	
65	2000mngapika2	s"ka	s"ka	8.27	+3	+3	
66	3000mlargPishat e buta	s"ka	s"ka	8.26	+3	+3	

Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet një situatë e ndryshme nga stacioni në stacion për sa i përket të gjithëve treguesve të cilësisë së ujrave. Për 3 stacionet e lumit Ishëm vlera e O të trejtur paraqitet e moderuar e klasifikohet e cilësisë së tretë. Tre stacionet e lumit Erzen

rezultojne të pasura me oksigjen dhe klasifikohet të cilësisës së parë, ku vecojme stacionin reference me permbajtje me te larte 9. 53mg/l.

Ndersa përsa I përkete përmabjtjes së NBO si dhe e NKO për Ishmin gjendja paraqitet problematike duke e kaluara nivelin e cilesë së keqe (klasa e pestë). Situata paraqitet problematike edhe për përmabjtjen e NO_2 e NO_3 .

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet nje shtate e ndryshme nga stacioni në stacion për sa i përket të gjithën treguesve të cilësisë së ujrave. Për 3 stacionet e lumit Ishem vlera e O të trejtur paraqitet e moderuar e klasifikohet e cilesisë së tretë. Tre stacionet e lumit Erzen rezultojne të pasura me oksigjen dhe klasifikohet të cilësisës së parë, ku vecojme stacionin reference me permbajtje me te larte 9. 53mg/l.

Ndersa përsa I përkete përmabjtjes së NBO si dhe e NKO për Ishmin gjendja paraqitet problematike duke e kaluara nivelin e cilesë së keqe (klasa e pestë). Situata paraqitet problematike edhe për përmabjtjen e NO_2 e NO_3 .

Shkaqet për këtë gjëndje janë shkarkimet e lengeta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve të zonës së autostradës.

Ujrat e cilësisë së ulët në të keqe paraiten edhe për përmabjtjen mesatre të foforit (ujrat e lumit të Tiranës dhe të Lanes që shkarkojnë në Ishëm).

Vlera me e larte te permbajtjes se amonjakut NH_4 paraqitet ne lumin e Lanes tek Ish dogana qe ndodhet pas shkarkimit te kolektoreve te ujerave urbane, te cilat jane pergjegjese direkte per keto vlera. Po keshtu paraqitet shtate edhe për lumen Erzene ne stacionet e fundit.

Sipas Raportit për Gjendjen e Mjedisit ne R.SH. (2014) rezulton Ujrat e lumejve vleresohen alkaline me pH nga 7 -8.3. Lumi i Ishmit dhe Erzen vleresohen me percjellshmeri të lartë elektrike që tregon ndikimin e vazhdueshëm të shkarkimeve urbane e industriale dhe lumi I Ishmit është kritik dhe përsa I përket përmabjtje NBO, P, që tregon prezencen e fuqishme të ndotjeve urbane dhe industriale. Kjo vërehet dhe nga përmabjtja e lartë e amonjakut nga shkarkimet e ujrave urbane të patrajtuara e industriale të lumit të Tiranës dhe të Lanës. Lumi I Ishmit mbetet lumi më I ndotur në Shqipëri.

Nga monitorimi i ujrave bregdetare është problematike sidomos ne Porto romano ku behen shkarkime urbane te patrajtuara. Kjo situatë do te permiresohet me venien ne kapacitet te plote te impiantit te trajtimit te ujerave urbane. Gjate vijes bregdetare ne Durres ka mjaft kanale e rrjedha te ndryshme qe derdhen ne det duke sjelle ndotjen e ujerave bregdetare e u berë rrezik potencial per pushuesit ne sezonin e veres.

Ujrat nëntokësore janë pasuria me rendesi jetike për popullatën dhe janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm me intensitet të lartë rritje dhe rrisht të përhershëm ndotje nga veprimtaritë natyrore e njerzore. Për ket arsye mere rëndësi të veçantë monitorimi I tyre. Në basenin e Erzen - Ishëm monitorohet akuiferi ujëmbajtës i zhavoreve të Kuaternarit të Tiranës me një rrjet monitorimi me 5 shpime dhe akuiferi ujëmbajtës i zhavoreve të Fushe - Krujës me 4 shpime. Për vitin 2014 rezulton koeficienti vjetor i shfrytëzimit në Tiranë $K = 0,85 - 0,95$

Ndersa temperatura mesatare e ujit ka rezultuar 17. 21°Celsius (norma 8 - 15, deri 20) ndersa vlera mesatare e pH për vitet 2010 - 2014 ka variuar 7. 18 - 7. 35. Vlerat mesatare të fortësisë së përgjithshme kanë variuar për vitet 2010 - 2014 në 19. 37 - 25. 42 °gjermane.


Mineralizimi i përgjithshëm mesatar për vitet 2010 - 2014 varion $M_p = 621.8 - 866.67$ mg/l. Uji është i tipit hidrokarbonat - kalcium- magnezi. Përmbajtja mesatare e Na për vitet 2010 - 2014 varion $25.99 - 77.8$ mg/l ndërsa Mbetja thatë mesatare varion $419-534.5$ mg/l. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion $105.44 - 132.27$ mg/l. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion $19.26 - 34.1$ mg/l dhe e Fe $0 - 0.04 - 0.06$ mg/l.

Po kështu, Përmbajtja mesatare e Cl për vitet 2010 -2014 varion $25.64 - 62.76$ mg/l, e sulfatëve (SO₄) varion $49.03 - 95.73$ mg/l, e nitrateve (NO₃) $11.11 - 23.47$ mg/l dhe e nitriteve (NO₂) është në sasinë nën 0.01 mg/l deri në 0.01 mg/l.

Zona ku shtrihet qyteti i Durrësit është e pasur me ujëra nëntokësore në nivelit të ceket që rrit në këtë mënyre vulnerabilitetin për t'u ndotur. Shtresëzimet ujëmbajtëse ushqehen nga ujrat e lumit Ishëm dhe Erzen. Këto ujëra janë të pijshëm dhe kanë pH prej 7 deri 9. Sipas specialisteve, këto ujëra rrezikojnë të ndoten nga prania në zonën e kënetës të vendgrumbullimit të mbetjeve, nga ndotja e mëparshme e mjedisit dhe tokës në zonën e lindanit dhe të bikromateve, nga ish fabrika e prodhimit të kimikateve me bazë sulfur.

Nga monitorimet e kryera për zonë rezulton se përqendrimi i lindanit në zonë zvogëlohet shumë qoftë në drejtim horizontal ashtu edhe në drejtim vertical, p.sh në thellësi 20 cm përqendrimi i lindanit është rreth 4 herë më i madh se në thellësinë 80 cm duke bërë që të mendohet se në thellësi 5-6 m sasia e tij zvogëlohet në përqendrime të pallogaritshme. Gjithashtu edhe ndërtimi i parkut energjetik në zonën e Porto Romanos krijon një rrezik edhe për ndotjen e ujërave nëntokësore.

Është i njohur fakti se burimet kryesore të ndotjes janë dhe mbetjet urbane (mbetje inerte dhe të lëngshme). Ndotja e ujit urban ndodh nga prania e P (fosforit) që e ka burimin nga detergjente të ndryshëm që përdoren kryesisht prej familjeve. Nitratet (Azotet) janë një tjetër element ndotës i gjendur në ujë, në formën e NO₂ dhe NO₃, që vjen prej aktiviteteve urbane, bujqësore dhe industriale. Ndotja më e madhe e ujit është ndotja mikrobiologjike që shkaktohet nga ujërat e zeza dhe që përfundojnë pa trajtimin e tyre, në lumenj dhe në forma të tjera në anë të rrugëve dhe kanalet natyrore të drenazhimit dhe përfundimisht derdhja e tyre në det.



Harta Hidrogeologjike

Uji i pijshëm.

Durrësi furnizohet dhe nxjerr ujë të pijshëm nga burimet ujore të Fushë Kuqes. Një pjesë e madhe e sistemit ekzistues ka qenë rinovuar dhe uji i burimit është higjenikisht i sigurt. Kjo bën që uji i pijshëm që vjen në rubinete të jetë i sigurtë.

Gjithashtu në disa zona populata përdor ujin e puseve, i cili duhet kontrolluar në mënyrë rigoroze duke pasur parasysh ndotjet e ujërave të cekta nëntokësore në zonën e Durrësit.

Plotësimi i nevojave në rritje të Durrësit mendohet se do të bëhet përmes prurjeve të reja nga Bovilla e Tiranës. Kjo do të thotë që prurjet në Durrës do të dyfishohen nga 350 l/s në rreth 700 l/s.

Duke u bazuar në vlerat e vetive fiziko-kimike dhe atyre bakteriologjike të marra nga Instituti i Shëndetit Publik, cilësia e ujit të pijshëm është pothuajse brenda gjithë standardeve kombëtare.

3. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

3.1 Ndikimet negative ne mjedis

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedisi gjatë të gjitha fazave të zbatimit të projektit, asaj parapregatitore, të ndërtimit të objektit janëveprimtaritë si:

- Gërmimet e tokës dhe dhe pastrimi e sistemi i sheshit ku do të ndertohej objekti;
- Demolimet e strukturave e objekteve ndërtimore te vjetra, brenda sheshit.
- Percaktimi i trajtimit i rrugëve për qarkullim të automjeteve në objekti e lidhja me ato jashtë tij.,
- Rrethimi i sheshit të ndërtimit.
- Ndërtimi i magazines së perkoheshme e vendi i qëndrimit te mjeteve, parkimin;
- Hapja e themeleve, punime germimi;
- Ndërtimi i themeleve dhe krejt objektit;

Keto veprimtari mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe social –ekonomik nga:

- Zenia e përkohëshme ose e tëpërherëshme e tokës;
- Përdorimi i makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit;
- Përdorimii karburantit gjatë ndërtimit;
- Gjenerimi i emisioneve në ajër;
- Gjenerimi i zhurmave nga automjetet per ndertimin si dhe i makinerive e pajisjeve që përdoren per ndertimin e objektit;
- Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të prodhuara.

Kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes janë:

- Marrja e përherëshme e tokës për ndertimin e objektit;
- Gjenerimi i zhurmave nga rritja e pranise se automjeteve;
- Rritja e pranise se banoreve dhe e presionit në mjedisin biofizik.

Ndikimi i karakteristikave aktuale klimatike mbi aktivitetet e projektit

Vendi ku zbatohjet projekti, qyteti i Durresi t'karakterizohet nga klimë tipike mesdhetare medimër të butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Këto karakteristika klimatike janë të përshtatshme për qëllime të të gjitha fazat e zhvillimit të projektit. Kështu, punimet e ndërtimit mund të realizohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Megjithatë është sugjeruar për të shmangur periudhat kur bie shi në punimet në mjedise të hapura e sidomos në lartësi.

3.2 Ndikimet ne biodiversitet

Zona në shqyrtim zotëron kryesisht lloje të bimësisë se kultivuar në anë trotuare në anë të rrugeve si dhe në lulishte e kënde të gjelberta. Sheshi i ndërtimit të objektit nuk prek investime të kryera në këtë drejtim por vetem do të krijojë siperfaqe të gjelberta buzë rrugeve e koridoreve qarkulluese.

Ndërtimi i magazinës sëtë përkohshme me ambientin zyrë për ndjekjen e punimeve, pastrimin i tërrenit ku do të ndertohet objekti, hapja e koridoreve të përkohëshe qarkullimi tek fronti i punes, punime të tokës për themelet e shtresat e objektit, transporti i materialeve, zhurma dhe vibracionet e krijuara nga aktivitetet e demolimeve dhe e ndërtimit, etj, përbëjnë burimet kryesore të ndikimeve në burimet ekologjike dhe të biodiversitetit në këtë zonë.

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat i modifikuar nga njeriu e jo natyror, shqetësime të kafshëve (kryesisht shpëndëve) të mjedisit urban ose megrim I përkohshëm i atyre të zonës më larg sheshit të ndërtimit shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe mekanizmave, ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme që mbështesin biodiversitetin.

Duke qënë se vendi ku do të ndertohet objekti është mjedis urban me dendësi deri të lartë të objekteve ndërtimore, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta përsa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i ulët.

Ndikimet në faunë

Ndikimet kryesore në grupe të ndryshme të faunës nga ndërtimi i objektit të propozuar mund të klasifikohen si shqetësim për eleminët faunistik urban.

Ndërtimi përfshin pastrimin e vegjetacionit në vatra të pakta të gjetura, gërmimit të dheut,

dhe lëvizja e mjeteve apo pajisjeve mbi rrugët dhe terren, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe aktiviteteve të tjera mund të rezultojë në lëndime apo eliminimin e kafshëve.

Për pocionin e sheshit të ndërtimit, ndikimet e tilla nuk mund të jenë të rëndësishme, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmash të cilat nuk janë të konsoliduara si komunitete apo popullata. Elementët faunistikë nuk karakterizohen nga ndjeshmeri e veçantë që të ndikohen në mënyrë specifike apo që të jenë të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë në këtë mjedis urban gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i rikthyeshëm.

Gjitarët

Aktiviteti mund të ndikojë në humbjen e drejtpërdrejtë duke tjetërsuar mjedisin përmes punimeve të ndërtimit, veçanërisht realizimin e themeleve. Në shumë raste, humbja e vendit nuk ka gjasa të ketë një ndikim potencial në popullatën e specieve. Këtu nuk ka mjedise me popullata të qëndrueshme të gjitareve por mund të jenë në gjëndje të largohen nga zona për të shmangur rrëmujën (siç janë lakuriqet e natës). Ndikimi mund të vlerësohet i ulët dhe i kthyeshëm.

Jovvertebrore, amfibet dhe zvarraniket, nuk përfaqësohen nga popullata të qëndrueshme veç atyre që banojnë në mjedise e strehe pranë banesave të ulta etj. Gjatë aktiviteteve të ndërtimit atom und të dëmtohen ose dalin dalin nga mjediset ku janë strehuar. Dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin të drejtpërdrejtë të popullsisë e amfibëve dhe zvarranikëve, si dhe faunës jovvertebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet shume e ulët.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Objekti Godine Banimi dhe Sherbimi 3-4-6 kate, me 1 kat nentoke qëndronë në terren urban me vlera të ulëta të biodiversitetit, (mungesës së specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara, zonat e mbrojtura, etj).

Nuk ka argumenta qëky objekt të jete pengesë e rrugeve migruese të shpendeve të ujit.

Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.

3.3 Ndikimet në ujë

Ujrat nëntoksore

Godine Banimi dhe Sherbimi 3-4-6 kate, me 1 kat nentokedo të vendoset në një zonë urbane me dëndesi objektsh ndertimore. Kjo zonë, e cila është e përbërë nga shtresezime që nuk ndikojnë në ndonjë aqufer të rëndësishëm i cili të influencohet negativisht nga shkarkimet e mundëshme por behet pjesë e një mjedisi urban të konsoliduar. Megjithatë shtresezimet ujëmbajtëse mund të ndotet nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të përdorura të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit të ndertimit.

Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore:

- Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Makineritë që punojnë nëndërtim dhe kamionet transportues, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.
- Rreziku i ndikimeve negative në ujin nëobjektet e furnizimit duke përfshirë zona të kufizuara rrethobjektit.

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundeshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të mesëm e të madhësisë së mesme.

Ndikimet e mundshme mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me veprimtaritë përgatitore të sheshit dhe veprimtaritë e ndryshme ndërtimore (ndërtimi i koridoreve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; themelet, ndërtimi i objektit etj), përfshijnë:

Rritja e pezullive në ujërat nga germime e dherave;

Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta, etj;

Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;

Erozioni në anët e gropës së hapur për ndërtimin e themeleve e katit nëntokësor dhe sedimentimi;

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të njëprobabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

3.4 Ndikimet në tokë

Nga ndërtimi i objektit do të ketë një humbje të sipërfaqes së patrajtuar aktualisht nga

ndertime infrastrukturore, objekte ndertimore, nga punimet toksore. Makinëritë e ndertimit si dhe makinëritë e renda që bejnë rregullimin e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojnë tokën në zonën rreth objektit.

Ndikimet e mundshme:

- Humbja e tokës së lirë nga ndertimi i objektit;
- Ngjeshja e tokës nga mjetet qarkulluese në zonën rreth objektit gjatë punimeve të ndertimit;
- Ndotja e tokës, e cila mund të ndodhë me derdhjet e naftës nga transporti dhe mjeteve të punës ose përmes ujërave të zeza dhe mbetjet urbane nga sektori i punimeve gjatë aktiviteteve të ndertimit.

Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohen të një rëndësie të vogël dhe me masë të kufizuar.

Tektonia dhe sizmiciteti

Ndikimet e mundshme

Nuk ka ndikime të mundshme që mund të gjenerohet nga aktivitetet e ndertimit por dëmet e mundshme për objektin mund të ndodhin në rast të tërmetejeve në qoftë se ata janë të përshkruar nga linja tektonike; etj

Projekti duhet të përputhet me vërtetimin sizmik të sheshit të ndertimit të leshuar nga Instituti i Sizmiologjisë, për parametrat e marre për llogaritjen e ngarkesës sizmike si intensiteti sizmik i truallit të ndertimit sipas shkallës Merkalit e kategorisë së truallit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka të tjera kërkesa të përdorimit të tokës gjatë fazave të operimit dhe mirëmbajtjes. Kërkesat për përdorimin e tokës janë plotësuar para fazës së ndertimit, me qëllim ndërtimin e këtij objekti.

Gjeologjia

Vendi ku vendoset objekti është e testuar nga ana gjeologjike nga ndertimi i objekteve të tjera ndertimore me volume ndertimore të lartësi katësh të ngjashme. Nga punimet përgatitore të terrenit ku do të ndertohet objekti mund të ndodhin fenomene të izoluar erozioni gjatë punimeve gërmuese e që janë me veprim të perkohshëm. Mund të ndikohet gjithashtu në lëngëzimin e mundshëm të tokës në vendin e themeleve pasi punohet dhe për një kat nëntokësor.

Keto ndikime të mundshme vlerësohen me probabilitetin të ulët dhe me madhësi dhe shtrirje për aq kohë sa ndërtohen objekti.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Ndikimet e parashikuara nga aktivitetet e operimit dhe të mirëmbajtjes që lidhen me parametrat gjeologjike, tektonike dhe sizmike në zonën e projektit nuk kanë ndonjë çështje specifike të panjohur që mund të merret në konsideratë. Ndersa dëmet e objektit në rast të tërmeteve potenciale janë të mundura.

3.5 Ndikimet në ajër

Vendi për ndërtimin e objektit në qytetin e Durrësit (lagja 18), është zonë e pambuluar me bimësi të kultivuar apo natyrore dhe cilësia e ajrit përgjithësisht është në nivele të pranueshme për zonat banuara qytetase pa evidentuar rastet e ndotjes nga industria të caktuara me ndikim potencial ndotës në këtë qytet. Durrësi nuk tejkalon standartin ditor të BE³ për PM10 si dhe PM 2.5, SO₂, NO₂ ndersa për CO ka tregues të rritur në krahasim me standartet kryesisht për shkak të rritjes së numrit të automjeteve qarkulluese në rrugët e qytetit.

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojnë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitetet që gjenerojnë pluhura janë ndërtimet e sektorit të punimeve, rregullime rrugore, pastrim bimësie, ndërtimi i objekteve dhe themelet e strukturave mbajtëse si dhe emisionet e gazit nga mjetet e transportit dhe pajisjet e ndërtimit. Pluhuri, grimcat dhe emetimet e gazeve mund të ndikojnë negativisht në biodiversitetin, burimet ujore dhe shëndetin e punëtorëve dhe të popullatës lokale. Shkarkimet në ajër mund të specifikohen emetimet të pluhurave dhe grimcave (PM₁₀). Emetimet me të mëdha pluhurave mund të ndodhin gjatë orëve të punës në aktivitetet ndërtimore.

Pluhuri nuk shkakton ndryshime afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në mjediset në afërsi shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojnë në ankesa, por që këto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës përgatitore dhe asaj të ndërtimit.

Ndersa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë mund të transportohen më gjërë sesa pluhuri nëpërmjet erës, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht e vogël, çdo efekt anësor që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit. Duke qënë se grimcat PM10 janë mjaft të vogla, ato tërhiqen në mushkeri gjatë frymëmarrjes dhe japin ndikim potencial për shëndetin.

Emetimet e gazeve: Ndotësit kryesorë në lidhje me të cilat janë të lidhur me trafikun rrugor gjatë ndërtimit janë NO₂, PM10, CO, benzen (C₆H₆) dhe benzopireni (C₂₀H₁₂). Emetimet e NO₂ dhe PM10 janë më shumë gjasa për të tejkaluar standardet përkatëse të cilësisë së ajrit për vëndin tonë në objekt në momente pikë të punimeve si dhe do të ndjehet në zonën

³ Sipas Raportit të gjendjes së mjedisit në RSH, 2014

që është periferike ose ngjitur me kantjerin e ndertimit. Nuk parashikohet që keto ndikime të shtrihen dhe të jetë potenciale në cilësinë lokale të ajrit.

3.6 Ndikimi në peisazh dhe vizualiteti.

Gjatë fazës së ndërtimit të objektit, do të ketë ndikime në vlerat e peizazhit urban dhe të pamjes në tëresi përmes ndryshimeve që do të ndodhin nga: pastrimin i vegetacionit të vendit ku do të ngrihet nestacioni dhe i rugeve të mundshme hyrese të përkoheshme në anë të tij,

- nga ndërtimi i sheshit të ndertimit duke bërë demolime të strukturave e objekteve egzistuese;
- nga qarkullimi i kamioneve të rëndë dhe nga prania e të gjithë aktivitetit ndertimor.

Nga përfundimi i objektit do të ketë ndikime në pejsazhin urban në këtë lagje nga prania e objektit të përfunduar por përceptimi do të jetë i moderuar për faktin se kemi të bejmë me volume të reja objektesh ndertimore por që sistemojnë nga pikamja mjaft element urban që lidhen me vijen e ndertimit apo lartësinë e kateve. Ndikim pritet të jetë i moderuar deri të mesëm mbi pejsazhin.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Në kushtet kur objekti do të jetë një zhvillim i ri urban duke u ekspozuar më më theks si objekt zhvillimor, ndikimi në pejsazh mund të klasifikohet i moderuar e me ndjeshmeri të mesme. Si një masë zbutëse është sugjeruar është rritja sa më shumë që të jetë e mundur e koridoreve e këndeve të gjelbërta rreth objektit, të shikohet mundësia e organizimit të hapësirave e strukturave për zhvillimin e gjelberimit në vetë objektin.

3.7 Përmbytjet

Nuk ka asnjë ndikim të parashikuar të përmbytyjeve gjatë fazës së operimit. Ndikimin e mundshëm të ngjarjeve të përmbytyjeve në zhvillimin e projektit, veçanërisht marrja parasysh e ndikimeve nga efektet nga ndryshimet klimatike zbuten nga marrja e masave të parashikuara.

Marrja e masave për të mos dëmtuar dëmtuar infrastrukturën kulluese gjatë ndertimit si dhe aplikimi i themeleve të strukturave të objektit sipas praktikave me të mira e kodeve ndertimore garantojnë mbrojtjen e nga përmbytjet gjatë operimit. Zbatimi i masave të duhura zbutëse, çon në një ndikim që vlerësohet i një rëndësie të vogël.

3.8 Ndikimi ne trashëgimisë natyrore dhe zonat e mbrojtura

Vëndi për ndertimin e objektit shtrihet në tokë të zhvilluar nga pikpamja urbane, me vlera të ulëta në drejtim të biodiversitetit. Nuk ka asnjë ndikim potencial tëparashikuar në florën dhe faunën në përgjithësi, dhe në specie endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti. Nuk ka zona të mbrojtura në afërsi të zonës së projektit.

3.9 Çështjet social ekonomike

Në lidhje me kontekstin lokal, zona e prekur do të jenë përfituesee drejtpërdrejtë nga aspekti ekonomik. Gjatë periudhës së ndërtimit, do të ketë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve të ndërtimit që do të punësohen nga popullsia e zonës afër vendit ku zbatohet.

Përfitimet do të shkojnë për kompanitë lokale të ndërtimit të kontraktuar. Aktivitetet e ndërtimit ndikojnë e ofrojnë kushte të favorshme dhe inkurajojnë bizneset e reja, ose shërbimet për punëtorët e ndërtimit.

Përdorimi i tokes

Ndertimi i objektit zhvillohet në një sipërfaqe terreni pronë private, dhe nuk kemi të bëjmë shpronësime dhe kompensime. Toka në këtë lagje të qytetit është destinuar nga zhvillimi urban pasi nuk ndodhet në zonë buferike të qytetit.

Ndersa çdo dëmtim mundur i objekteve infrastrukturore, pronave etj, afër objektit duhet të kompensohen ose duhet të restaurohen në të njëjtën gjendje e saktë si para ndërtimit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Projekti do të kontribuojë për zhvillimet e mëtejshme urban në këtë lagje e përmirsimin e mjedisit urban.

Projekti do të ndikojë pozitivisht në plotësimin e kërkesave në rritje për apartamente banimi si dhe mjedise shërbimi në nivel lokal, duke përfshirë aktivitetet ekonomike dhe punësimi në këtë qytet, i cili është ndër më të rëndësishmit të Shqipërisë pas Tiranës.

3.10 Ndikimi në infrastrukturë

Efektet negative të infrastrukturës ekzistuese, që lidhen me ndërtimin e objektit, janë kryesisht:

- Dëmtimi i infrastrukturës ekzistuese si pasojë e qarkullimit të kamioneve të rëndë e atomjeteve të transportit.
- Shqetësim mund të ketë edhe për rastet kur rruget hyrëse në objekt do të jenë të ngushta për automjetet.

Me zbatimin e masave përkatëse, ndikimi i mundshëm në infrastrukturë vlerësohet i një rëndësie të vogël dhe të masës lokale.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka asnjë ndikim tëparashikuar e që të ketë lene gjurmë negative në infrastrukturën ekzistuese, gjatë operimit dhe mirëmbajtjes, por do të përmirsohet fleksibiliteti urban.

3.11 Trashëgimia kulturore

Sipas ligjit "Për trashëgiminë kulturore", para fillimit të punimeve të ndërtimit është i nevojshëm miratimi nga Agjencia e Sherbimit Arkelogjik. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik është institucion qendror, në varësi të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, e krijuar për të ushtruar veprimtari në fushën e gërmimeve dhe të studimeve të trashëgimisë kulturore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit. I gjithë personeli në zbatim të projektit duhet të trajnohet për të ndaluar punimet në qoftë se ndonjë objekt me vlerë historike ose para-historike është gjetur. Nëse kjo ndodh kjo, ndërtimi nuk duhet të fillojë deri sat ë autorizohet nga institucioni publik kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Nga vezhgimet ne terren si dhe nga prania e objekteve të ngjashme egzistuese nuk pritet të ndodh një rast i tillë.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka ndikim të pritshëm në trashëgiminë kulturore gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Procesi i përzgjedhjes së vendndodhjes ka lidhje më pronësinë dhe tiparet urbane të zonës, dhe nuk është dashur ndonjëshmangie që lidhet me praninë e objekteve të trashëgimisë kulturore e objekteve historike.

3.12 Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Faza e ndërtimit të shteses sëobjektit të propozuar do të favorizojë punësimin e njënumri të konsiderueshem puntorësh në zonën që pritet fillimi i punimve të projektit. Punëdhënësi dhe të punësuarit do të jenë të detyruar të ndjekin përcaktimet e përfshira në aktet e ndryshme ligjore në fushën e punës dhe legjislacionit për mbrojtjen sociale. Masat duhet të jenë të përshkruara në drejtim të mbrojtjes së të punësuarve. Këto masa përfshijnë ndërmarrjen e detyrave të caktuara nga ana e personelit të kualifikuar, dispozitat për pajisje të përshtatshme

personale të mbrojtjes, shmangien e aktiviteteve gjatë kushteve të keqesuara të motit, për ofrimin e shërbimeve sanitare dhe pajisje të mirëqenies në vend, si dhe identifikimin e duhur të rrezikut dhe vlerësimit të tij. Këto masa, së bashku me angazhimin në përputhje me ligjet e shëndetit dhe sigurisë shqiptare do të sigurojnë themelin mbi të cilin do të bazohet shëndeti dhe siguria e punonjësve.

Kushtet e punës dhe kompetetë punës do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të punës. Mjedisi i qëndrimit dhe i punës për punëtorët do të jetë i përshtatshëm, i pastër, i sigurt, për të siguruar nevojat bazë të punonjësve.

Kompania zbatuese do të jetë përgjegjëse për Shëndetin dhe Planin e Sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Investitori do të shqyrtojë dhe të miratojë këto plane dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e performancës së zbatuesit. Të gjithë punëtorët do të trajnohen në lidhje me rregullat dhe procedurat e duhura të sigurisë.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Qëllimi i të gjitha programeve të shëndetit dhe sigurisë në punë është për të nxitur një mjedis të sigurt për veprimtarinë njerezore e për banim. Funkcionimi i objektit dhe mirëmbajtja do të kërkojë zbatimin e kërkesave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet për godina banimi të mjedisëve të përbashkëta. Ndersa për objektet prone private në përberie të godinës janë përgjegjës pronaret e tyre në aspektin e sigurisë dhe të cilësisë mjedisore.

3.13 Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Aktivitetet e ndërtimit do të sjellin ndryshime të kufizuara në mënyrën e jetës së banorëve të pallateve kufizuese të objektit. Lëvizja dikur e lirë dhe e pakufizuar të njerëzve dhe fëmijëve në një pjesë të mjedisëve të sheshit mund të bëhet me e kufizuar për shkak të pranisë së kamionëve dhe makineri.

Është e rëndësishme që komuniteti të njohe e të jetë i informuar në lidhje me vendin e zbatimit të projektit për arsye të levizjeve të paautorizuara që mund të ndodhin në vendet e ndërtimit nga fëmijët dhe të rriturit e qëmund të shkaktojë pasoja të rënda për këta individëve. Rrethimi i sheshit të ndërtimit dhe mbajtja nën kontroll, rrit masat e sigurisë në këtë drejtim. Zbatuesi I punimeve do të jetë i detyruar për të zhvilluar dhe zbatuar procedurat për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e publikut. Kjo do të përfshijë trajnime për punëtorët dhe personelin e sigurisë për të parandaluar qasje të paautorizuara në vendet e ndërtimit, zonat e qarkullimit të mjeteve të ndërtimit, si dhe zonat e magazinimit të pajisjeve.

Gjatë fazës së ndërtimit, ka probabilitet minimal për punëtorët të vuajnë nga sëmundje të caktuara infektive. Çështjet e mundshme të shëndetit publik nga sëmundjet e ndryshme nga speciet vektoriale, nuk ka probabilitet të vlerësuar e të jetë i ndikueshem gjatë zbatimit të projektit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Gjatë fazës operacionale, objekti nuk ka ndikime të cilat mund të konsiderohet si një rrezik shëndetësor të komunitetit. Gjatë fazës operacionale nënstacioni nuk do të lëshojë substanca ndotëse dhe të dëmshme në mjedis dhe nuk do të gjenerojë sasi të shumta mbeturinash. Në këtë aspekt projekti i propozuar nuk do të krijojë kushte mjedisore të cilat mund të çojnë në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore në zonën e projektit, por do të ndikojë në rritjen e mundësisë së strehimit, të cilësisë së kushteve të banimit, të rritjes së aktiviteve të shërbimit etj.

4. Shkarkimet e mundshme nëmjedis

4.1 Shkarkimet e ujërave të ndotura

Ndikimet e mundshme nga shkarkimet në ujërat nëntoksore

Objekti Godine Banimi dhe Sherbimi 3-4-6 kate, me 1 kat nentoke sipas projektit do të vendoset në Lagjen nr. 18, rreth 200 m ne përendim të stadiumit të qytetit, në një zonë të zhvilluar nga ana urbane në të gjitha anët. Ujrat nëntoksore mund të ndotet nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të përdorura të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit të objektit.

Ndikimet e nga shkarkimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore:

- Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura tokën;
- Makineri në ndërtim dhe kamionet transportues të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.
- Rreziku i ndikimeve negative në ujin nëinfrastrukturën furnizuese duke përfshirë periferinë e objektit.

Në zonë nuk ka puse hidrogeologjike të hapura në akuiferet kuaternare zhavorere të për furnizimin furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë, për pasojë nuk ka ndjeshmëri për ndikimin të mundshme të aktiviteteve të projektit në ujërat nëntokësore.

Megjithatë marrja e masave për ndalimin e shkarkimeve ndotese është e rëndësishme. Nëse nuk merren masa, ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore janë vlerësuar të nivelit të ulët e me probabilitet të moderuar të madhësisë të moderuar.

Gjate fazes se operimit, ndikimet e mundshme janë të papërfilleshme pasi do të unifikohet me shkarkimet ne rrjetin e qytetit.

Ndikimet e mundshme nga shkarkimet mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me parandërtimore dhe veprimtaritë e

ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; ndërtimet, etj), përfshijnë:

- Rritja e pezullive në ujërat të nga germime e dherave;
- Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta, etj .;
- Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;
- Erozioni dhe sedimentimi;

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale. Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes.

Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së operimit.

4.2 Shkarkimet e gazeve dhe pluhurave

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojnë pluhura janë krijimi i sheshit të punimeve, rregullime rrugore, pastrim bimësie, ndërtimi i objektit si dhe emisionet e gazit nga mjetet e transportit dhe pajisjeve të ndërtimit. Shkarkimet në ajër mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm_{10}). Emetimet me të mëdha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitet ndërtimorë.

Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa por që këto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës përgatitore dhe asaj të ndërtimit.

Ndërsa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri nëpërmjet erës, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht i vogël, çdo efekt anësor që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit. Duke qënë se grimcat PM10 janë mjaft të vogla, ato tërhiqen në mushkeri gjatë frymemarrjes dhe japin ndikim potencial për shëndetin.

Emetimet e gazit: Ndotësit kryesorë në lidhje me të cilat janë të lidhur me trafikun rrugor gjatë ndërtimit janë NO₂, PM10, CO, benzen (C₆H₆) dhe benzopireni (C₂₀H₁₂). Emetimet e NO₂ dhe PM10 janë më shumë gjasa për të tejkaluar standardet përkatëse të cilësisë së ajrit për vëndin tonë në objekt në momente piku të punimeve por jo në numrin e diteve mesatare si dhe do të ndjehet në mjedisin periferik ose ngjitur me kantjerin e ndërtimit. Nuk parashikohet që ndikime të shtrihet dhe të jetë potencial në cilësinë lokale të ajrit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk do të ketë burime potenciale shkarkime ndotese në ajër por vetem ato që lidhen me emetimet nga ngrohja e gatimi në apartamentet e banimit si dhe nga aktivitet e sherbimeve. Ndikimet zbutese varen nga masat në nivel lokal që lidhen me shkarkimet ne qytet.

4.3 Zhurmat

Zhurma do të gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si eskavatorë, fadroma, vinça, etj.

Tabela bashkangjitur paraqet nivelin e zhurmës të krijuar nga disa automjete dhe makineri, të cilat janë përdorur në punimet e ndërtimit.

Tabela : Automjetet dhe makineri në punimet e ndërtimit dhe nivelet e tyre të zhurmës

Nr	Tipi/modeli	Niveli i zhurmes dB(A)
1	Fadrome	111
2	Eskavator	108
3	Kamion rul	112
4	Rul, kamion me vibrim	116
5	Buldozer	113
6	Makineri të tjera	103
7	Kamion në rrugën me zhavorr	64
8	Kamion në rrugën e asfaltuar	61

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Zhurma operacional është i lidhur me funksionimin e objektit për banim dhe sherbime. Gjatë funksionit nuk ka burime potenciale të zhurmave nga apartamentet e banimit por vetem në rastet e ambienteve të sherbimeve që varet nga natyra e sherbimet. Në rast të verpimtarive që gjenerojnë duhet të merren masa të përshtatshme për minimizimin e tyre për të cilat ka mundësi të plota e aplikime e përvoja të njohura per t'u zbatuar.

4.4 Vibrimet

Ndikimi nga vibrimet në tërren varet ngashume faktore. Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar faktorë fizike, si amplitude, kohëzgjatja dhe përmbajtja e frekuencave të vibracioneve, si dhe faktorë të tjerë si lloji i popullsisë, mosha, gjinia dhe pritjet të cilat janë fiziologjike. Sipa kësaj reagimi i njerëzve për vibracionet është subjektiv dhe kjo ndryshon për njerëz të ndryshëm. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Tabela në vijim paraqet distancat në të cilën dridhjet mund të jetë të dukshme për lloj të caktuar të aktivitetit të ndërtimit. Këto shifra janë të bazuara në matjet historike në terren dhe të dhanat

nga literatura.

Për shkak të afërsisë së objekteve të banimit e shërbimeve në afërsingë vendi ku zbatohet projekti, ka mundësi që dridhjet nga ndërtimi i objektit të propozuar të jenë evidente. Të vetmet burime të vibrimit që të merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatëqarkullimit në objekt.

Aktivitet e ndërtimit	Distanca (ne m) nga ku mund të perceptohet vibrimi
Germimet	10-15
Kompaktesimi, ngjeshja me vebrim	10-15
Kamionat e rëndë	5 - 10

4.5 Prodhimet e mbetjeve

Në këtë fazë, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit. Keto mbetje janë të ndryshme, si copa betoni të thyera e materiale inerte nga demolimet e objekteve, nga krijimi e sistemimi i sheshit të ndërtimit, mbetje gjatë ndërtimit etj. Nuk pritet krijimi i mbetjeve që vijnë nga mirëmbajtja e objektit por vetëm ato të natyrës urbane nga banoret e aktivitet e shërbimeve.

Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme

Burimet e gjenerimit të mbetjeve të ngurta janë kryesisht nga punimet e tokës për themelet, pastrimit të bimësisë, punimeve mekonstruksione metalike, betonit, të rërës, zhavorrit, mbeturina ushqimore. Mbetjet të rrezikshme përfshijn vajra, karburante, graso, etj, të cilat mund të rrjedhin nga aktivitetet e ndërtimit dhe operimit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së objektit, prodhimi i mbetjeve të rrezikshme janë të nivelit të ulët dhe lehtësisht të administrueshme pa krijuar ndikime potenciale në mjedis.

5. Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Analize e përmbledhur e kohezgjatjes së ndikimeve negative në mjedis

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedis vetëm gjatë të fazës së zbatimit të projektit, ku përfshihet ajo parapregatitore e terrenit dhe të ndërtimit të objektit lidhen me veprimtaritë si vijon:

- Sistemimi i sheshit të ndërtimit, gërmimet e tokës dhe demolimet për pastrimin e sheshit;
- Ndërtimi i magazines e mjedisit zyre për mbikqyresit e zbatuesin e punimeve, percaktimi i vendqendrimit të mjeteve;
- Hapja e truallit, ndërtimi i themeleve evadimi i dherave;
- Percaktimi i rrugëve e koridoreve të qarkullimit nësheshin e ndërtimit.
- Ndërtimi i objektit.

Ndikime të përherëshme mjedisore dhe sociale gjatë funksionimit të objektit ku përfshihen edhe aktivitetet e mirëmbajtjes janë:

- Marrja e përherëshme e tokës për ndërtimin e objektit;
- Ndryshimi në pejsazhin urban;
- Rritja e prezencës së automjeteve nga hyrjet e daljet në parkimin nëntokë;
- Rritja e numrit të banorëve në godinën e banimit si dhe prania të punonjësve dhe e frekuentuesve të mjedisëve të shërbimit në katin përdhë.

Impaktet e parashikuara, gjatë punimeve të ndërtimit që mund të zgjasin rreth 15 muaj nuk do të jenë të rëndësishme për cilësinë e ajrit në zonë.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në biodiversitet

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat artificial urban, shqetësimi i grupeve të kafshëve ose migrimi i përkohshëm i atyre në zonës në afërsisht kaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe makinerive. Po kështu ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme për të mbështetur biodiversitetin urban. Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i mjaft kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësi të pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ujërat nëntoksore

Ndikimet e mundshme që do të zgjasin vetëm gjatë fazës ndertimore janë:

- Punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Aktivizimi i makinerive në ndërtim dhe transport, të cilat mund të sjellin rrezikun endotjes nga karburanti dhe vaji.

Ndikimet e mundëshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë të përkohëshme dhe do të zbuten duke aplikuar praktikatat më të mira për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me fazen parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe të kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; strukturat mbajtëse, themelet, etj), përfshijnë: Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësoretë cilat janë vlerësuar të jenë të ulët, të njëprobabiliteti të ulët dhe me shtrirje vetëm lokale.

Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore e nëntoksore, gjatë fazës së operimit.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në tokë

Ndikimi me kohezgjatje pa limit është jetersimi I përdorimit të tokës nga punimet e vendosjen e objektit të ri për banim e shërbime. Makinëritë e ndërtimit si dhe makinëritë e renda që bejnë mbathjen e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojë tokën në afërsi të objektit.

Ky ndikim pavarësisht nga kohezgjatja, efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët e me shtrirje lokale duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdormit të saj.

Nuk ka ndikim të pritshëm në përdorimin e tokës gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ajër

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojne pluhura jane ndertimet e sektorit te punës, rregullime rrugore, pastrime e demolime për formimin e sheshit të ndërtimit, ndërtimi i objektit. Shkarkimet ne ajer mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm₁₀). Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet e germimeve e ato ndertimore. Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës

pregatitore dhe asaj të ndërtimit. Ndersa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe që mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri, nëpërmjet eres, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht i vogël, çdo efekte anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Ndersa gjatë fazës së operimit, ndikimi mund të zbutet duke marrë masat e duhura, të ngjashme me fazën e ndërtimit.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, vinça, etj.

Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumëfaktorë fizike ku përfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Për shkak të faktit se ka prona banimi në afërsi të objektit, ka gjasa që vibrimet nga ndërtimi i objektit të propozuar të jetë të evidentueshme.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme në peisazh dhe vizualiteti.

Ndikimi në peisazhin urban të lagjes 18 është i dukshëm por duke pas parasysh se objekti është shtuar krahas objekteve të tjera të banimit si dhe shërbimeve egzistuese, perceptimi në ndryshim pejsazhi është jo shumë potencial dhe i ambientueshëm me pamjen. Si përfundim perceptimi veçanërisht në distancë do të jete i moderuar për faktin se kemi të bejmë me zhvillim të objekteve të reja që ruan vijën ndërtimore të atyre egzistuese.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga gjenerimi i mbetjeve

Në fazën ndërtimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qënë se shumica e aktiviteteve të ndërtimit rezultojnë me mbetje të kufizuara e jo të rëndësishme, sidomos nga përdorimi i elementeve ndërtimor të parafabrikuar. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit.

Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.

Gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së objektit, prodhimi i mbetjeve të natyrës urbane është normalisht i administrueshëm pasi do të shërbehet me pikat me kontejnere në lagje për banoret si dhe aktivitetet e shërbimeve.

6 Tëdhëna përshtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

6.1 Distancën fizike nga vendndodhja e projektit.

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit në mjedis mund të shtrihet vetëm në një zonë periferike të kufizuar nga objekte e tjera ndertimore si pallate, por përgjithësisht nuk mund të jetë jashtë hapësirës së territorit ku shtrihet ndertimi i objektit veçanërisht gjatë fazës së operimit. Ndersa të vetmet burime të vibrimit që merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatë udhëtimit për në objekt.

Për aktivitetet e ndërtimit distance nga ku mund të përceptohet vibrimi është si vijon:

Punimet gërmuese të tokës deri 10 -15 m largësi.

Kompaktësimi dhe ngjeshja me vibrim 10 – 15 m largësi.

Levizja e kamioneve të rëndë, 5 deri 10 m.

6.2 Vlerat e ndikuara

Biodiversiteti

Duke qënë se vendi ku do të ndertohet objekti është sipërfaqe truall në një zonë të zhvilluar urbane nga të gjitha anët, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta për sa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale urbane dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i papërfillshëm.

Fauna

Ndikimet në faunë është i ulët e jo i rëndësishëm, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmave, qëndrohen në popullata të rregullata e të qëndrueshme osë që janë veçanërisht të ndjeshëm, të pa aftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i kthyeshëm.

Jovetebrore, amfibet dhe zvarraniket,

Dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin të drejtpërdrejtë të individëve rastësore, si dhe faunës jovertebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet e ulët dhe e papërfillshme.

Ujra nëntoksore

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të ulët, të madhësisë së ulët.

Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje locale gjatë fazës së ndërtimit.

Ujrat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të njëprobabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

Ndikimet në tokë

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët duke mos marrëparasysh tjetërsimin e përdormit të saj si dhe me shtrirje locale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin racional të rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara. Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet të një rëndësie të papërfillshme si dhe në masë të vogël.

Ndikimi në ajër

Ndikimi, i aktivitetëve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale

Ndikimi nga zhurmat

Zhurma gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, kamionet, etj, për të cilat ka matje të caktuara të nivelit të zhurmës së tyre.

Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë të krijuar. Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Rregulloren e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmave në mjedise të caktuara".

Nuk ka asnjë ndikim negative të parashikuar për banorët përreth nga zhurma e gjeneruar nga objekti gjatë fazës operacionale. Ndikimi negativ në kafshët e egra ka gjasa të jetë i papërfillshëm.

Ndikimi nga vibrimet

Vibrimet gjenerohen kryesisht gjatë aktivitetit të ndertimit. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme.

Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndertimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogla dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.

Ndikimet në pejsazh dhe vizualitet.

Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndertimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitete të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të objektit si element zhvillimor urban më objektet e tjera të ngjashme egzistuese. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm mund të vlerësohet të një rëndësie të ulët.

Gjenerimi i mbetjeve

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndertimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme rehabilitimit janë marrë.

7 Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar

7.1 Mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve në këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmjet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësive natyrore të trashëguara të mjedisit, mbrojtja e shëndetit të punonjësve, mbrojtja e cilësisë së ujrave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin.

Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemit të terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shëndetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që

adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike.

Sistemimi i sheshi tëndertimit të objektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinerike tëketij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës nëvartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngusht me respektimin e kushteve teknike inxhinerike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqeve të sheshit midis elementeve të ndertimor të objektit, koridoret qarkulluese e të sherbimeve të mirembajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe e zhvilluar urbane me objekte banimi, rruge e trotuare dhe duhet tërestaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme duke ju referuar praktikave më mira restauruese e rehabilituese në tëresi që risjellin e promovojnë vlerat e pejsazhit si dhe cilësitëe kësaj zone urbane. Në këtë mënyrëndikohen në rritje tëcilësisë mjedisore urbane dhe në përmirsimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen nga erozioni etj.

Mundesimi i gjelberimit në objekt nga projekti më të gjitha menyrat që lëjon një mjedis i tillë urban duhet të bëhet për të plotësim sa më maksimalisht kërkesat përmiruese e restauruse estetike dhe ekologjike.

Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore urbane janë në vartësi të volumit të kurores vegjetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendësisë së përdorimit të llojit.

Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që bëhet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe sigurimi e ruajtja e vendit nga mosdëmtimi, gjatë punimeve rehabilituese.

Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të ndertimit të objektit ndertimor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë shërbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në objekt.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga teritori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Ndalimi i çdo veprimtarive që ka të bëjë më direkt ose indirekt me aktivitet ndertimor.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës.

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar urban me funksion të shumfishtë ripërtritës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishëm ka nëpërmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke përmirësuar aspektin pamor.

Masat e sugjeruara

- Përdorimi i bimeve dekorative që të përshtatet me kerkesat estetike dhe që garanton suksesin e përmirsimit të pejsazhit urban.
- Përdorimi i nje shtrese me matërial të tillë që të ndaloje mbirjen e barerave të këqija rreth fidaneve, ruajtjen e për ruajtjen e lageshtirës.

Mbjellja e fidaneve

Mbjellja behet me anë të fidaneve të prodhuar ne fidanishte të llojeve dekorative. Skemat e mbjelljes të llojeve behen duke respektuar dendesinë lejuar si dhe kombinimet e llojeve.

Mirëmbajtja

Punimet për mirëmbajtjen lidhen me sherbimet që kërkojnë rritja e bimesisë për plotësimin e kërkesave për ujë, element ushqyes, krasitje, pastrim etj. Në mënyrë të veçantë do të bëhet menjeherë zevendesimi i fidaneve që rezultojnë të deshtuara në mbirje ose që zhvillohen të dobët në krahasim me pjesën tjetër.

Monitorimi

Monitorimi lidhet me të gjithë aspektet e mbarvajtjes së nderhyrjeve rehabilituese për të garantuar suksesin e saj. Inspektimet e vazhdueshem ne lidhje me zenien e fidaneve e të gjendjes se vegjetacionin në tëresi do të sherbejnë për marrjen e masave te menjehershme të vijushmërisë së sukseseshme të rehabilitimit.

7.2 Kostotfinanciare të përafërta për rehabilitimin

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit janë të paraqitura në tabelen në vijim ku janë patrashtruar edhe kostot e përafërta financiare. Masat e identifikuara ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tëresi ku kostot e vleresuara përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

Veprimtaria	Efektet potenciale	Plani i minimizimit e zbutjes se ndikimit	Pergjegjesia	Kosto e përafert ne \$
Pastrimi e pergatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje e demtimi i struktures se tokes se zones ne afersi	Rrethimi i sheshit te ndertimit. Ndalimi i nderhyrjeve te panevojshme ne afersi. Krijimi isektorit te punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kerkesave teknike e zhvillimore te objektit.	Zhvilluesi	800 (pa elementet e sektorit)

		Vendosja e tabelave sinjalizuese		
Sistemimi i vendit te punes	Presioni ne sistemin drenazhues dhe erozionin e tokes	Berja e zbatimi i nje plani drenazhimi per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe evitimi i pellgjeve me uje.	Zhvilluesi	1200
Hapjet e themeleve	Emetime ndotese ne ajer	Levizja e evadimet e dherave te behen ne kushtet e lagies per uljen e pluhura. Sperkatja e herepas-hershme e stoqeve, mbajtja e mjedisit paster.	Zhvilluesi	2000
Punimet e ndertimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndertimit duhet te jene sipas Direktivave Standarteve te Komunitetit European 2000/14/EC, Maj. 2000. Kjo directive aplikohet tek prodhuesit e pajisjeve qe gjenerojne zhurma. Te gjitha pajisjet duhet te mbahen ne kushte te mira.	Zhvilluesi	Te vogla
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim ne ndotjen e tokes Ndikimi ne shendetin e punonjesve	Caktimi, i vendit te administrimit e trajtimit te mbetjeve. Marrja e lejeve nga Njesia e Qeverisjes lokale per vendosjen e dherave. Sigurimi i paisjeve personale mbrojtese nga pluhurat. Evitimi i shpejtesive te panevojshme te automjeteve	Zhvilluesi	1000
Punimet operatore ne objekt	Mungesa e vegjetacionit	Hartimi i një projekti për gjelberimet e mundeshme. Mirembajtja	Studio projektuese Zhvilluesi	3000
Punime operatore	Rreziku i demtimit te infrastruktures urbane	Mirëmbajtja e riparimi i menjehereshme sipas rastit.	Zhvilluesi	1000 (gjate ndert).
Prodhimi i mbetjeve te rrezikshme si dhe ujrave te zeza gjate operimit e funksionimit	Ndotja e tokes, e ujrave siperfaqesore e nentoksore	Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve. Lejet, per lidhjen me rrjetin urban te kanalizimeve, ujesjelles etj. Marrveshjet e kontratat me subjektetsipas rastit.	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvilluesi • Pronaret e apartamentev e • Subjektet qe kryejne sherbimet 	2000 (nga zhvilluesi gjate ndertimit)

8. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Biodiversitet

Masat të ndryshme zbutëse do të jenë të nevojshme në sheshin e ndertimit në minimizimin e ndikimeve në biodiversitetin urban.

Punimet e pastrimit të vendit e të përgatitjes së themeleve të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Evitimi i hyrjeve të tjera në sheshin e ndertimit dhe përdorimi sa më shumë që të jetë e mundur i rrugët ekzistuese të aksesit dhe të minimizimi i hyrjeve të reja.

Limitimi i shtrirjes së aktivitetit ndertimor do të mbeshtesë e do të evitojë shqetësimet në faunën urbane.

Administrimi i mbeturinave në mënyre të përshtatshme.

Mënjeherë pas përfundimit, të restaurohen vatrat e degraduara si rezultat i aktivitetit ndertimor.

Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësi të pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

Ujrat nëntoksore

Është e nevojshme marrja e masave të përgjithshme të praktikës së mirë ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat nëntokësore, gjatë përgatitjes dhe fazat e ndërtimit. Shmangia sa më shumë që të jetë e mundur zonat ku ka sisteme furnizimi me ujë. Nëse merren këto masa zbutëse, ndikimet e mundshme mund të reduktohet në një probabilitet të papërfillshëm dhe të rëndësisë vetëm lokale.

Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme duhet të zbutet duke aplikuar praktikën më të mirë për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Ujërat sipërfaqësore

Është e nevojshme zbatimi i një sërë masash të përgjithshme të praktikës së mirë të ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit të objektit. Duhet të merren masa zbutëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ujërat e zeza dhe nga mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme qëndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore mund të reduktohet në një rëndësi të papërfillshme, dhe në masë lokale.

Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit,

për zonen e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët më shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikatat e duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.

Cilesia e tokës

Masat zbutëse përfshijnë:

- Përdorimi i rrugëve ekzistuese si rrugët hyrëse në sektorin e punimeve;
- Rrethimi i sheshit të ndërtimit për të minimizuar demtinin e terrenit në zonën periferike;
- Kryerja e punimeve të ndërtimit gjatë periudhave të thata, kur toka nuk është e ngopur;
- Zbatimi i praktikave më të mira për zbutjen e ndotjes së tokës nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme.

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdormit të saj si dhe me shtrirje lokale Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara.

Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet të një rëndësie të vogël dhe të masë të kufizuar.

Tektonia dhe sizmiteti

Të aplikohen praktikatat më të mira ndërkombëtare në lidhje me kushtet gjeoteknike për ndërtimin e objektit. Në përputhje me Eurokodi 8, është e rekomanduar ndërmarrja e njëstudimi të detajuar gjeoteknik dhe sizmologjik për vendin e ndërtimit;

Do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndërtimit të komponentëve të projektit të propozuar.

Gjeologjia

Masat zbutëse përfshijnë:

- Aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me vlerësimin gjeoteknik të vendit të objektit. Studimi i detajuar gjeotektonik dhe sizmologjik në përputhje me Eurokodet 7 dhe 8, rekomandohet para të fazës së ndërtimit.

Masat e propozuara duhet të merren për të siguruar praktika më të mira gjatë fazës së ndërtimit të objektit të propozuar. Aktivitetet e projektit duhet të marrë në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventuale

negativ të tilla si lëngëzimi e tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime velrësohet me probabilitetit të ulët, me madhësi e shtrirjen lokale. Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Me marrjen e masave zbutëse përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme.

Per cilesine e ajrit

Masat zbutëse të rekomanduara janë:

- Shmangja e përdorimit të rrugëve në të gjithë zonën e banuar, nga kamionë të transportit. Shmangja sa më shumë që është e mundur e kalimit të kamionëve të transportit të rëndë në të zonën e banuar;
- Mbulimi i kamioneve të transportit dhe stotopeve të matërialeve për të evituar ndikimin e përhapjes së pluhurave nga era;
- Spërkatje e stotopeve dhe rrugët e hyrjes me ujë, gjatë sezonit të thatë për të minimizuar pluhurin;
- Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rrezikun nga pluhuri dhe të tjera substancave ndotëse;
- Të sigurohet që të gjitha automjetet e ndërtimit të jenë nënshtruar mirëmbajtjes së rregullt dhe të përshtatshme në kushtet teknike, në përputhje me specifikimet e sipas prodhuesve e standarteve;
- Përdorimi lëndëve djegëse, të cilat janë në përputhje me standardet zyrtare (sipas Urdhëresa nr 6, nga 09.10.2007, përmbajtja e sulfurit në naftë, duke filluar nga 01.01.2011 duhet të jetë 10mg max/kg);
- Monitorimi i cilësisë së ajrit në bazë të VKM Nr.435, të 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër, në territorin e Shqipërisë", VKM Nr 803, dhjetor 2003, "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe VKM Nr 103, i 31.3.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë". Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra të kontrollit të tyre" përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye;
- Ligji nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Konkluzion: Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi objektit të nëstacionit shtesë dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura.

Zhurmat

Masat zbutese lidhen me respektimin e standarteve ligjore gjate ndertimit e operimit te objektit te propozuar.

Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë të krijuar. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen si më poshtë:

- Dita zgjat 13 orë, nga 0600 deri në 1900;
- Mbrëmja zgjat 4 orë, nga 1900 deri në 2300; dhe
- Nata zgjat 7 orë, nga 2300 në 0600.

Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Rregulloren e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmave në mjedise të caktuara",

Tabela : Nivelet e brezit të zhurmës në varësi të mjedisit(sipas udhezimit nr.8, date 27.11.2007 per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara).

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha baze (ore)	LAmaz Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashte)	45	8	
Institucione				
Klasa mesimi institucione-mjedise parashkollore(brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshtiresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	
Dhoma te fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri I shkolles, vendet e lojtravene Shkolle	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-

Spitale,salla,dhoma(brenda)	Prishja e gjumit naten	30	8	40
	Prishja e gjumit ditën dhe në mbremje	30	16	
Spitale,salla trajtimi(brenda)	Ndikim në pushim, clodhje	#1		
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale,tregtare,qarkullimi Trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të rëndshme	Dëmtim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festival dhe argetime	Dëmtim degjim (klientet<5here/vit)	100	4	110
Muziken e përmjet kufjeve të degjimit	Dëmtim degjimi	85#4	1	110
Tinguj– zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe arme të zjarrit	Dëmtim degjimi (te rriturit) Dëmtim degjimit (fëmijet)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zona të mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

Spjegime:

$LA_{eq}(dBA) = \text{Niveli i kuivalentit matur në shkallën A}$

Koha baze (ore) = Koha gjatë së cilës bëhet matja

$L_{Amax\ Fast} (dB) = \text{Niveli i matur në shkallën A në mënyrën Fast (e shpejtë)}$

#1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

#2 = Presioni zanor maksimal ($L_{Amax, fast}$) matur 100 mm larg veshit.

#3= Zonat jashtëmetë qetaduhet të mbrohet dhe raportit i zhurmës hyrës/shtesë me zhurmen e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

#4 = Në kufjet e degjimit, përshtatur me vlerat fushës së lirë.

Vibrimet

Masat lehtësuese sugjeruara përfshijnë:

- Të sigurohet që shpërndarja e materialeve të ndërtimit në sheshin e ndërtimit është e

përfunduar vetëm gjatë orëve të dites;

- Kryerja e inspektimeve të rregullta dhe mirëmbajtja e motorëve të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Të sigurohet që punëtorët janë të përdorin pajisje të mbrojtjen nga zhurma;
- Respektimi i standardeve zyrtare mbi zhurmat dhe vibracionet të parapara me Ligjin Nr.9774 12 korrik 2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis";
- Monitorimi i zhurmave dhe dridhjet nga aktivitetet e projektit siç specifikohet nga Urdhëresa e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, e 27 Nëntor 2007 "Për kufijtë për zhurmave në mjedise të caktuara", si dhe në VKM Nr 103, datë 31 mars 2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë", dhe në VKM nr 587, Korrik 07, 2010 "Për zhurmës monitorimit në zonat urbane dhe turistike".

Konkluzion: Ndikimet negative nga zhurmat dhe vibrimet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogla dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.

Peisazhi dhe çeshtjet vizuale

Masat zbutëse të propozuara:

- Mundësimi në mënyrë sa më maksimale në kushtet e objektit të përdroimit të gjelberimit; Minimizimin e zonave që përdoren përkohësisht për qëllime ndërtimi;
- Minimizimi i ndërtimeve eventuale të qasjes së re të rrugëve hyrese në objekt dhe përdorimit të sa më shumë të jetë e mundur rrugët ekzistuese duke respektuar kushtet e rrugore të përdorimit;
- Shmangia sa më shumë të jetë e mundur e rreziqeve gjeologjike të tilla si erozioni, rrëshqitjet e tokës gjatë ndërtimit.

Konkluzion: Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitete të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të vepres ngjitur me nenstacionin egzistues. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

Përmbajtjet

Masat zbutëse të propozuara:

Mirëmbajtja e rrjetit të kullimit dhe kanalizimeve me të cilat lidhet sheshi i ndërtimit dhe objekti.

Konkluzion: Në zonën e objektit të propozuar ndikimi i mundshëm nga përmbajtjet mund të vlerësohet i ulët, me probabilitet të moderuar, e madhësi të vogël e mesem e shtrirje lokale. Nëse merren masat e duhura zbutëse, këto ndikime mund të reduktohen në një probabilitet të ulët.

Çështjet socio-ekonomike,

Përdorimi i tokës

Nuk parashikohen demtime të pronave afër objektit, në rast dmëtimi ato duhet të kompensohen ose duhet të restaurohen në gjendjen e mëparshme.

Trashëgimia kulturore

Sipas ligjit "Për trashëgiminë kulturore", para fillimit të punimeve të ndërtimit është i nevojshëm miratimi nga Agjencia e Sherbimit Arkeologjik. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik është institucion qendror, në varësi të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, e krijuar për të ushtruar veprimtari në fushën e gërmimeve dhe të studimeve të trashëgimisë kulturore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit. I gjithë personeli i kontraktuar në zbatim të projektit duhet të trajnohet për të ndaluar punimet në qoftë se ndonjë objekt me vlerë historike ose para-historike është gjetur. Nëse kjo ndodh kjo, ndërtimi nuk duhet të fillojë deri sa të autorizohet nga institucioni publik kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Nga vezhgimet në terren si dhe nga prania e objekteve të ngjashme kufitare egzistuese nuk pritet të ndodh një rast i tillë.

Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm nga ana kulturore mund të vlerësohet i ulët.

Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Kushtet e punës dhe kompetencat e punës do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të punës. Qëndrimi për punëtorët do të jetë i përshtatshëm, i pastër, i sigurt, për të siguruar nevojat bazë të punonjësve.

Zhvilluesi do të jetë përgjegjës për Shëndetin dhe Planin e Sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Të gjithë punëtorët do të trajnohen në lidhje me rregullat dhe procedurat e e duhura të sigurisë.

Kerkesat teknike, estetike e ekologjike

Masa teknike:

- Per veten natyren e projekti, respektimi i kriterëve teknike të operacioneve gjatë të gjithë veprimtarisë së zbatimit të projekti është i një rëndësie të veçantë.
- Zbatimi i shesheve të distancave të sigurisë prej elementeve të infrastrukturës ku punohet etj, mbrojtja rigoroze gjatë gjithë periudhës së zbatimit e garantimi i sigurisë në objektet sipas projektit për periudhën që funksionon.
- Respektimi i plotë i Regullores së Sigurimit Teknik që lidhet dhe me mënyrën e zgjidhjeve teknike e zbatimit të tyre të të gjitha operacioneve të punës.

Masa estetike e ekologjike

- Rishikimi e kujdesi per vegjetacionin në çdo kënd qëështë i mundur ose ato që mund të jetë demtuar ose nga punimet zbatuese.
- Demtimet në rruget hyresë që mund të ketë ndodhur duhet të rehabilitohen për të arritur në performancën mjedisore egzistuese të mjedisit të ndikuar.

Parandalimi i rreziqeve

Për parandalimin e rreziqeve, aktiviteti duhet të mbeshtetet ne Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjen ne Punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatimin e tyre të lëshuar nga dikasteret përkatëse.

Subjekti duhet të percaktojë si detyre ligjore vendosjen e tabelave në vënde të dukshme dhe natën të ndriçuara me pjesët kryesore të rregulloreve të sigurimit teknik, sigurimin e kushteve e mjeteve mbrojtese.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në pune do të jenë nder problemet me kryesore për subjektin gjatë gjithë fazës zbatimit të projektit dhe garantimit te sigurisë ne objektet gjate gjithë periudhes së zhvillimit të projektit dhe venies ne punë të nenstacionit shtesë. Aspektet e sigurise duhet te respektohem me rigorozitet te larte konform standerteve teknike ligjore per ketë objekt duke i dhene rendesi gjithashtu aspektit tregues e sinjalizues. Për kete duhet të vendosen tabelat përkatëse në të gjithë zonen e parashikuara në projekt konform standerteve teknike ligjore per kete qellim.

Situatat e veçanta që mund te krijohen nga mosnjohja e kushteve teknike te punes, pakujdesite e ndryshme kërkojnë një vlerësim maksimal të masave mbrojtese e respektimin e rregullores se sigurimit teknik. Në kryerjen e te gjitha operacioneve te punës, duhet të punësohen specialistë me eksperiencë e të kualifikuar në përputhje me kërkesat e profilin e operacioneve te punes. I gjithë aktiviteti në zbatim të projekti duhet te drejtohet nga personel i kualifikuar i cili do të zbatoje rregullat e percaktuara ne rregulloren e teknikes se sigurimit per çdo rast.

Ne ketë rregullore percaktohen:

Detyrimet e punëdhënesit

Punëdhënesi vetë ose nepermjet drejtuesit teknik duhet t’u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Pajisjet dhe automjetet që përdoren në operacionet e ngarkim shkarkimit.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre sipas specifikes se aktivitetit.

- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të leshuara nga dikasteret që lidhen me to.
- Veçoritë e punës në, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes për menjanimin e aksidenteve sidomos në kushte të veçanta (reshje, lageshtire etj).
- Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me proceset e punes, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjesve të tjerë, të cilët kryejnë këtë aktivitet ose të tjerë që janë vizitore.
- Ndihmen e parë shendetsore
- Të kryeje instruktim paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik për operacione specifike ngarkim shkarkimi.

Detyrimet e punëmarrsit:

- Të njohë mirë përdorim e pajisjeve dhe makinerive për shfrytëzimin e tyre.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundshme të aksidenteve per çdo proces pune.
- Të siguroje vehtën e punonjesit e tjerë gjatë procesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhë të parë, merr masa për eliminimin e saj, ndërkohë lajmëron gjithë punonjesit për rrezikun.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Firma zbatuese e punimeve, duhet te mane masa per trainimin e personelit per nderhyrje te shpejta ne rast avarish gjate procesit te punes sipas kerkesave te MNZ-se. Firma ndertuese duhet te zbatoje me rigorozitet kerkesat e MNZ-se per te perfshire brenda ketij projekti vendosjen e fiksave brenda ambjenteve te punes.

Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Është e rëndësishme që komuniteti të njohë e të jetë i informuar në lidhje me vendin e

zbatimit të projektit për arsye të levizjeve të paautorizuara që mund të ndodhin në vendet e ndërtimit nga fëmijët dhe të rriturit e qëmund të shkaktojë pasoja të rënda për keta individëve. Rrethimi i sheshit të ndërtimit dhe mbajtja nën kontroll rrit masat e sigurisë në këtë drejtim. Zhvilluesi do të jetë i detyruar për të zhvilluar dhe zbatuar procedurat për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e publikut. Kjo do të përfshijë trajnime për punëtorët dhe personelin e sigurisë për të parandaluar qasje të paautorizuara në vendet e ndërtimit, zonat e qarkullimit të mjeteve të ndërtimit, si dhe zonat e magazinimit të pajisjeve.

Konkluzion: Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm mund të vlerësohen të një rëndësie të ulët.

Gjenerimi i mbetjeve

Per zbutjen e ndikimeve propozohen keto masa:

Ujërat e zeza duhet të largohen në destinacione të përshtatshme, nga subjekte të licensuara e të monitoruara nga DRM dhe autoritetet lokale.

Ndikimet e përkohshme e ujërave të zeza të gjeneruara nga aktivitetet e projektit mund të zbutet duke zbatuar një Plan Menaxhimi Mjedisor për ujërat e zeza.

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme

Ndikimet e përkohshme e mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme mund të zbutet duke zbatuar një planin e menaxhimit për mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme, të cilat duhet të jenë të përgatitur para se të periudhës së ndërtimit, dhe në përputhje me:

Ligjin me Nr.10 463, datë 22.9.2011, " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ” i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve; Ligjin Nr 9537, datë 18.05.2006, "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme"; dhe VKM Nr 103, të 31.03.2003, "Për monitorimin e mjedisit", i cili në përputhje me Direktivën 2006/12 / EC "Për Mbetjet".

Per zbutjen e impakteve në tokë shërben sistemimi e organizimi i përshtatshëm i mjedisit të punës. Firma zbatuese duhet të marrë masa e përgjegjesitë për administrimin e përshtatshëm të mbetjeve sipas rastit e natyrës së tyre.

Konkluzion: Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme rehabilitimit janë marrë.

9.Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkuftar

Shtesa e nenstacionit megjithese behet pjese e sistemit ne rrjet shperndares ndershteteror të energjisë, nuk sjelle ndikime të veçuara e specifike mjedisore që kanë varësi e ndërveprim nga të qënurit nëketërrjet.

10. Përfundime

Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti, veprimtaritë që do të japin ndikime të mundshme negative në mjedis gjatë të gjitha fazave të këtij procesi, asaj parapregatitore, të ndërtimit të objektit e të venies në funksion janë veprimtaritë ndertimore të cilat mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe social – ekonomik. Për keto ndikime ky raport i VNM-së ka specifikuar masa konkrete zbutese të ndikimeve. Në këtë raport janë parashtruar gjithashtu në mënyrë të detajuar dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes. Nga vlerësimi i ndikimit në mjedis të ndërtimit të objektit arrihet në keto përfundime:

- Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit rezultojnë të një rëndësie pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese. Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.
- Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme, në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonen e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët me shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikave të duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.
- Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.
- Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara.
- Për tektoninë e sizmicitetin, do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndërtimit të komponentëve të projektit të propozuar.
- Aktivitetet e projektit duhet të marrë në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventual negativ të tilla si lëngëzimi e tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime vlerësohet me probabilitet të ulët, me madhësi e shtrirjen lokale. Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Me marrjen e masave zbutëse përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme
- Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk

ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale.

- Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogla dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.
- Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitete të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të vepres ngjitur me nenstacionin egzistues. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.
- Nuk ka asnjë ndikim të parashikuar të përmbytjeve gjatë fazës së operimit. Ndikimin e mundshëm të ngjarjeve të përmbytjeve, veçanërisht marrja parasysh e ndikimeve nga efektet nga ndryshimet klimatike zbuten nga marrja e masave të parashikuara.
- Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme të rehabilitimit janë marrë.
- Nuk ka asnjë ndikim negativ potencial të parashikuar për banorët për rreth nga zhurma e gjeneruar nga fazës operacionale. Ndikimi negativ në kafshët e egra është i papërfillshëm.

Ne Raportin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis është parashikuar zbatimi i projektit duke pasur parasysh të gjitha kushtet për mbrojtjen e mjedisit, bazuar në të gjithë kuadrin ligjor mjedisor shqiptar.

Ky raport kontrollon nga organet shtetërore kompetente.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shoqërohet me ndikime potenciale në mjedis por jep një kontribut pozitiv në zhvillimin urban, në rritjen e numrit të apartamenteve për strehim si dhe të mjedisve për shërbim të qytetit të Durrësit.

Masat për mbrojtjen e mjedisit të parashtruara në këtë raport janë të plota për minimizimin e ndikimeve në mjedis.

KULD shpk me nr. Nipti

K88304501J

**License e QKL-se nr. LN-7295-01-
2014**

Date 26.05.2016

EKSPERT MJEDISI

Jak GJINI

Çertifikuar sipas Vendimit Nr.
10, datë 24.07.2008 të me nr. 531
Prot. nga Ministria e Mjedisit.